



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

603/19

Nr \_\_\_\_\_ prot.

Shkodër, më 09.10.2023

**PLAN – MASASH**

**PËR PERBALLIMIN  
E SITUATAVE EMERGJENTE SEZONALE (VJESHTE-DIMER 2023-2024) NË  
TERRITORIN E QARKUT SHKODËR .**

Bazuar në Ligjin Nr.107/2016 “Për Prefektin”, Ligjin, Nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, Vendimi Nr. 655, datë 18.12.2002 “Për Ngritjen dhe Funksionimin e Strukturës së Sistemit Kombëtar të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile”, VKM, nr.414, dt.8.07.2021 “Për miratimin e Procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile”, VKM, nr. 594, dt.13.10.2021 “Për miratimin e subjekteve private, strukturat përgjegjëse për identifikimin e tyre, si dhe rregullat për realizimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre”, VKM, nr.158, dt.17.03.2021 “Për miratimin e kritereve dhe procedurave për shpalljen e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore” si dhe në kuadrin e masave që duhet të marrim për sezonin Vjeshtë-Dimër 2023-2024, Prefektja e Qarkut në rolin e Kryetares së KMCQ, në mbledhjen e KMCQ të datës 10 Tetor 2023, delegon detyrat e mëposhtëme:

1. **Masat e Institucionit të Prefektit (Brenda muajit Tetor 2023).**
  - a. Nga Institucioni i Prefektit po përditësohen planet e parandalimit, përballimit të emergjencave, dhe të planifikimit të rrezikut për përmbytjen, izolimin nga dëbora, pikat e kontaktit dhe sistemet e paralajmerimit të hershëm, skemat e informimit me të gjithë bashkitë dhe drejtuesit e institucioneve që ushtrjnë aktivitet në territorin e Qarkut.
  - b. Në kuadrin e Plan-Monitorim/Inspektimit vjetor kanë vijuar dhe do vijojnë inspektimet në terren, për të parë nga afër masat mbrojtëse dhe parandaluese për përmbytjet dhe emergjencat dimërore, të marra nga drejtuesit e institucioneve në nivel qendror dhe lokal.
  - c. Do të kërkojmë nga Autoriteti Verior, hartimin e Planit të Masave për ndërhyrje dhe kontrollin për zbatimin me korrektësi të kontratave nga kompanitë private për mirëmbajtjen e akseve rajonale në territorin e Qarkut.

- d. Në varësi të precipitimit të situatave do të ndjekim e monitorojmë mbledhjet e Komisioneve të MC në të gjitha bashkitë e Qarkut Shkodër, për përballimin e situatave emergjente që mund të krijohen nga reshjet e shiut apo të dëbores.
- e. Do inspektojmë masat e marra nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit për mirembajtjen, garantimin e kanaleve të para, argjinaturave, mireorganizimin e vrojtimit në të gjithë sistemin e mbrojtjes së zonë së nënshkodres, masat për monitorimin e situatës hidrike të lumenjve, gjëndjen e digave, dambave, dhe përcaktimin e mënyrave të informimit periodik për ndryshimet e kuotave/niveleve të prurjeve të lumenjve, gjëndjen e hidrovorëve, niveli i lumenjve, rezervuarët problematikë, argjinaturat, digat, dambat, etj.
- f. Në rastet e precipitimit të situatës do kërkojmë nga të gjitha institucionet në nivel qendror dhe bashkitë të bëjnë grafiket e shërbimit gjatë 24 orëve për secilen administratë, mbi bazën e urdhërave të drejtuesve të institucioneve me qëllim monitorimin e situatës në çdo bashki dhe institucion që ushtron aktivitetet territorin e Qarkut Shkodër.
- g. Të ndodhur përballë masave parandaluese të krizës energjitike do të kërkojmë nga strukturat e, KESH, nivelin e kaskadës në tre bazent e H/C-ve, të Drinit, sasinë e prurjeve dhe Shkarkimëve si dhe në raport me precipitimin e situatës do të bëhet lajmërimi i hershëm i popullsisë që rrezikohet nga përmytja, nëpërmjet njoftimit respektiv të bashkive që rrezikohen nga përmytjet.
- h. Do kërkojmë nga OSHE, OST, mbajtjen në gadishmeri dhe ndërhyrjen në kohë për furnizimin me energji të subjekteve të rëndësishë së vecantë si dhe bashkëpunimin me të gjithë institucionet, subjektet shtetërore dhe private që ushtrojnë aktivitet në territorin e Qarkut Shkodër, për një disiplinë dhe regjim të rreptë të kontroll-monitorimit të konsumit të EE nga të gjitha subjektet dhe abonentët.
- i. Do të kërkojmë nga të gjithë bashkitë dhe institucionet anëtare të KMC, raport dhe informacion periodik për zonat e evidentuara si problematike, kritike për përmytje ku rrezikohen banesa apo biznese, gjendja e akseve rrugore, furnizimi me ujë, me energji elektrike, emergjencat shëndetësore, masat e marra nga ana e strukturave operacionale, strukturat e angazhuara, mjetet, problematikat të hasura, si dhe, çdo informacion tjetër me vlerë për mirëmenaxhimin e situatës që mund të krijohet në territoret e përgjegjësishë nga emergjencat e përmytjeve dhe ato dimërore.
- j. Do të mbahet kontakt i vazhdueshëm nga të gjitha strukturat me Qendrën Kombëtare Operacionale të Mbrojtjes Civile (QKOMC) dhe AKMC.
- k. Do bashkëpunojmë me nënkryetarin e KQ për të kordinuar punën e administratës së Këshillit të Qarkut, bashkëpunimin me administratat e bashkive/institucioneve anëtare të KMCQ, për marrjen e shkëmbimin e informacionit të ndërsjelltë, dhe për të mundësuar akordimin për llogari të pesë bashkive të fondeve për mirëmenaxhimin e situatës që mund të krijohet nga përmytja apo izolimi nga dëbora.
- l. Do mbeshtesim dhe konsultojmë për interpretimin e VKM, nr.414, për procedurat e përdorimit të fondeve të EC të planifikuara dhe të kushtëzuar për familjet në nevojë dhe për investimet në fushën e EC në çdo bashki.

2. **Masat e Drejtorisë Vendore të Policisë së Shtetit, (DVP) FNSH, Qarkullimit Rrugor në zbatim të nenit, nr.35 të Ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, të realizohen dhe informohet Institucioni i Prefektit, brenda muajit Tetor 2022) per:**
  - a. Forcimin e bashkëpunimit me Sektorin e Planifikimit të Emergjencave Civile dhe Krizave pranë Institucionit të Prefektit, nëpërmjet sallave operative në nivel qendror dhe lokal, për të dhënë informacion të përditshëm në situata normale dhe emergjente, për të gjithë territorin e përgjegjësisë së Qarkut dhe për cdo bashki, pasi të kenë komunikuar me kryetaret e bashkive, institucionet përgjegjëse dhe SPZ e zonave.
  - b. Të freskojnë planet e emergjencave dhe nderhyrjes operationale, skemat e lajmërimit me drejtuesit e institucioneve shtetërore, bashkitë dhe qendrat administrative me qëllim shkëmbimin e informacionit të ndërsjelltë, kryesisht në zonat më problematike që izoloohen nga përmytja/dëbora, në territoret e 5 bashkive.
  - c. Të monitorojë, kontrollojnë dhe ndërhyjnë me strukturat e specializuara për të ndëshkuar kompanitë private të cilat nuk zbatojnë detyrimet kontraktuale për pastrimin e akseve rrugore dhe garantimin e përdoruesve të mjeteve.
  - d. Të marrin masat e duhura për sigurimin e rendit publik në zonat e emergjencës, nëse shpallet fatkeqësi natyrore.
3. **Reparti i FNSH, të zbatojnë planet operationale për të krijuar mundësinë e ndërhyrjes së strukturave përkatëse (ekipet e specializuar të evakuim shpëtimit dhe barrierat mbrojtëse) për shpëtimin e jetës së komunitetit në zonat që mund të izoloohen nga përmytja/dëbora, duke bashkëpunuar me drejtuesit e bashkive.**
4. **Strukturat e Qarkullimit Rrugor në të gjithë territorin e Qarkut:**
  - a. Të garantojnë disiplinimin e transportit të mjeteve në të gjitha akset që rrezikohen prej izolimit nga përmytja/dëbora, ngricat, të bashkëpunojnë me kryetaret e 5 Bashkive me Autoritetin Rajonal Verior të Rrugëve për të shkëmbyer informacione të ndërsjellta për verifikimin e vendeve të depozitimit të granilit, kripës dhe vendpërqendrimin të mjeteve të firmave që kanë aktmarrëveshje me këto drejtori për nderhyrjen në kohën e duhur në pastrimin e akseve nacionale.
  - b. Të evidentojnë, informojnë dhe të vënë në dispozicion të gjithë resurset logjistik dhe njerëzor që disponojnë kryesisht për garantimin e levizjes së përdoruesve të mjeteve qarkullimin rrugor në të gjithë territorin të Qarkut dhe disiplinimin e mjeteve në akset ku rrezikohen nga ngricat/përmytjet.
  - c. Të merren masa për kontrollin dhe sigurimin e garantimit të transportimit të ndihmave në rastet e ngricave dhe nga përmytjet.
  - d. Me qëllim miremenaxhimit e situatës në tërësi, dhe përqendrimin e forcave në zonat më problematike, të bashkëpunojnë me KMCQ dhe Kryetaret e bashkive për të rekomanduar ndërprerjen e qarkullimit në ato akse apo segmente në rastet kur rrezikohet jeta e përdoruesve të mjeteve, apo e komunitetit, sic është segmenti Qafë Thores, Qafë Mali, etj.
5. **Strukturat e ushtrisë (Rep.Ush.Vau Dejës) në zbatim të nenit, nr. 34 të Ligjit, nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”.(Brenda Muajit Tetor 2022)**
  - a. Të aktivizojnë Planet Operacionale në territoret e përgjegjësisë së operimit të tyre.

- b. Të bashkëpunojnë me KMCQ dhe kryetaret e bashkive, për të mbështetur komunitetet në zonën e rrezikut, me forcat dhe mjetet logjistike të kalueshmësië së lartë, që kanë në dispozicion, nëpërmjet kërkesës të bërë pranë Institucionit të Prefektit.
  - c. Të organizojnë evakuim/shpetimin e komunitetit dhe gjënë e gjallë duke bashkëpunuar me KMC të bashkivë që rrezikohen nga përmytjet, për në vendet e planifikuara të akomodimit të përkoheshëm të planizuara nga bashkitë.
- 6. Masat për drejtuesit e DSHP, Spitaleve, ISKSH, NJVKSH, në zbatim të nenit, nr. 37, të Ligjit, nr 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” si dhe në kuadrin e vijimit të masave anti Covid-19.**
- a. Të përditësojnë planet e masave shëndetësore në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë në nivel qendror dhe me bashkitë për monitorimin e të gjithë territorit me shërbim mjekesor.
  - b. Të sigurojnë prezencën e asistencës shëndetësore me mjekë dhe infermierë në çdo fshat, veçanërisht në zonat më problematike.
  - c. Të sigurojnë rezervat me medikamente mjekësore në të gjitha spitalet dhe QSH në territorin e Qarkut, veçanërisht në fshatrat e thella malore.
  - d. Të organizojnë bashkëpunimin ndërmjet strukturave shëndetësore dhe bashkive, ndarjen e përgjegjësië për marrjen e shkëmbimin e informacionit të ndërsjellët për transportimin e komunitetit në çdo rast të emergjencave shëndetësore.
  - e. Të sigurojnë gadishmerinë dhe prezencën e përsoneit infermier të spitaleve rajonale dhe QSH për t’i ardhur në ndihmë përsoneve të rrezikuara.
  - f. Të saktësojnë kompetencat dhe përgjegjësië me strukturat e MSH për të siguruar informacionin me qëllim për t’ju përgjigjur në kohe reale emergjencave shëndetësore në të gjithë territorin e Qarkut dhe Bashkive, nëpërmjet transportit ajror.
  - g. Në bashkëpunim me DVPO, QRR, FNSH, Bashkitë të organizojnë dhe ndjekin operacionet e emergjencave shëndetësore në të gjithë territorin e Qarkut me flutrimet nga ajri sipas kërkesave të bëra nga bashkitë për emergjencat shëndetësore, duke garantuar informacionin, vendodhjen e sakte dhe transportimin e të sëmureve për në spitalet më të afërta.
  - h. Të sigurojnë furnizimin dhe transportin e medikamenteve antigrip në kuadrin e detyrave të deleguara nga MSH në zonën e emergjencës, si dhe procesin e vaksinimit covid-19, apo zbatimin të rregullave anticovid, sipas porosive dhe protokollit të MSH
  - i. Persa më sipër të informohet Institucioni i Prefektit **(Brënda Muajit Tetor 2022)**
- 7. Masat e Autoriteti Verior. Të informojnë brenda Muajit Tetor 2022, për :**
- a. Mbi bazën e planeve të masave në rolin e ekspertëve, të verifikojnë kontratat e BB me kompanite privatë të miratuara për ndërhyrje në nivel rajonal dhe lokal.
  - b. Të verifikojnë konkretisht në terren prezencën dhe sasine e mjeteve, apo të granilit të kripes që kanë konkretisht sipas kontratave, kompanitë siper marrëse në nivel rajonal dhe lokal.
  - c. Të kenë në dispozicion dhe në gadishmeri teknike të gjithë mjetet dhe grupet e specilaisteve që të monitorojnë/kontrollojnë sistematikisht firmat private të kontraktuara për ndërhyrjen në hapjen e rrugëve nacionale dhe rurale, duke informuar sistematikisht Prefektin.

- d. Të bashkëpunojnë me strukturat e DVP, qarkullimin rrugor, për mbikqyrjen, kontrollin dhe ndjekjen sipas procedurave ligjore të kompanive private të cilat nuk zbatojnë kontratat aktuale të sipërmarrjes.
- e. Te angazhohen maksimalisht për reagim të menjëhershëm në akset Q.Mali, Vermoshit, Qafë Thores dhe në rastet e pa mundësisë së ndërhyrjes për shkak të rrezikut të jetës, duhet të bashkëpunohet me strukturat e DVP për ndalimin e qarkullimit dhe me strukturat e DSHP, vetëm për emergjencat shëndetësore.
- f. Të informojnë sistematikisht Institucionin e Prefektit për situatën e akseve, cdo 24 ore.
- 8. Masat e Drejtorisë Rajonale Arsimore. Brenda Muajit Tetor të informojnë për:**
  - a. Të aktivizojnë planet e masave emergjente me qëllim për të siguruar në vazhdimësi procesin mesimor në bashkëpunim me kryetaret e bashkive.
  - b. Në bashkëpunim me bashkitë të merren masat për përgatitjen e bazës logjistike të ngrohjes në të gjitha ambientet e mesimdhënies në të gjitha nivelet e shkollave në territorin e Qarkut.
  - c. Në varësi të precipitimit të situatës në zonat e emergjencës të propozojnë ndërprerjen e mësimin në këto zona duke planifikuar procesin e mesimdhënies për realizimin e programit, pas daljes nga emergjenca.
- 9. Masat e Strukturave të OSHEE, OST. Të informojnë brenda Muajit Tetor, për:**
  - a. Te hartojnë Planin e emergjencës në kuadrin e krizës energjetike, sipas VKM së Qeverisë dhe njohjen e tij nga KMCQ dhe të gjitha nivelet e institucioneve dhe bashkive për zbatim.
  - b. Të kordinojnë punën me të gjitha subjektët shtetërorë dhe privatë, agjensitë ligjzbatuese për mirëpërdorimin e energjisë, kursimin e tij dhe sanksionimin e cdo subjekti që shkelë rregullat apo abuzon me energjinë elektrike.
  - c. Të sigurojnë bazën materiale për riparimin e defekteve të mundshme.
  - d. Të verifikojnë dhe mbajnë në gadishmeri teknike të plotë, linjat e transmetimit të TU, TL, TM dhe në bashkëpunim të sigurojnë furnizimin me energji të hidrovorëve dhe institucioneve me rëndësi të veçantë sidomos të zonave që mund të preken nga fatkeqësitë në të gjithë territorin e Qarkut.
  - e. Të aktivizojnë planet operacionale të ndërhyrjes me grupet e punës/avarive në të gjithë territorin e Qarkut për evidentimin dhe riparimin e menjëhershëm të defekteve, duke siguruar vazhdimësinë e furnizimit me energji në zonat e emergjencës.
  - f. Të jepet informacion në kohë reale për të gjithë territorin e Qarkut në KMCQ.
- 10. Masat AKU, Ekspansionit, Veterinarisë**
  - a. Të riaktivizojnë Planin e Masave në kontrollin e sigurisë ushqimore në të gjithë territorin e Qarkut.
  - b. Të bashkëpunojnë me të gjithë drejtuesit e Bashkive, bizneseve ushqimore të shumices për monitorimin dhe garantimin e nevojave ushqimore më të domosdoshme për komunitetin e zonave malore dhe që mund të izoloohen nga përmytjet/dëbora dhe garantimin e sigurisë ushqimore brenda parametrave të konsumit.
  - c. Të bëjnë planin e mbështetjes së gjëse së gjallë dhe sigurimin paraprak, me bazë ushqimore, deri në një muaj, në bashkëpunim me bashkitë, ku të përcaktojnë vendet e evakuimit të përkohshëm të gjëse së gjallë, sipas matrikullimit.

**11. Masat për Drejtorinë dhe Ujitjes dhe Kullimit Lezhë .**

- a. Të hartojnë programet e ndërhyrjes dhe të organizojnë specialistet e tyre lokale me strukturat që disponojnë për të mbajtur në gadishmeri teknike dhe nën kontroll hidrovorët, argjinaturat, pritrat, kanalet kulluese në të gjithë territorin e Qarkut.
- b. Të ushtrojnë kontrole dhe inspektime të herëpashershme me specialistë të bashkise për monitorimin dhe sigurinë e argjinaturave në të gjithë ultësirën e Shkodrës, duke njoftuar sistematikisht Institucionin e Prefektit dhe kryetaret e bashkive për gjendjen e tyre.
- c. Të kenë Organizuar sistemin e vrojtimit me anë të vrojtuesve në të gjitha veprat ujore që shtrihen në territorin e Qarkut Shkodër, vecanërisht në ultësirën e Shkodrës dhe të informojnë Institucionin e Prefektit kryetaret e bashkive në mënyre permanente për situatën aktuale të rritjes së niveleve në lumenjtë Bunë, Drin dhe në Liqenin e Shkodrës.

**12. Masat nga N/Prefektët .**

- a. Në zbatim të këtij Plani Masash të bashkëpunojnë, monitorojnë e mbikqyrin dhe të informojnë periodikisht Institucionin e Prefektit për mbledhjet e KMC në nivel bashkie dhe funksionimin e bashkëpunimit të strukturave në cdo bashki për menaxhimin e situatës.
- b. Të bashkëpunojnë me institucionet e Komisaritet, Shëndetësisë, Arsimit, Bordet e kullimit dhe perfaqesuesit e të gjithë institucioneve të nivelit lokal në cdo bashki për sigurimin e rezervave me medikamente mjekësore e sigurimin e druve të zjarrit në shkolla, hapjen e rrugeve, sigurimin me energji elektrike dhe miremenaxhimin e situatës në territorin e përgjegjësisë, duke raportuar periodikisht cdo ditë prane sekretarise së KMCQ, me email ose nëpërmjet grupit Ëhatsuup.

**13. Masat që duhet të merren nga kryetaret e bashkive, në bazë të nenit, nr.30 te Ligjit “Për MC”, VKM, nr.414, dt.8.07.2021, VKM,nr. 158, dt.17.03.2021, VKM, nr.594, dt.13.10.2021. Të informojnë Brënda Muajt Tetor, për:**

- a. Të aktivizojnë planet e emergjencave, të ndërtojnë sistemin e përpunimit e të dhënave për zbatimin e detyrave të planizimit dhe të përbalimit të emergjencave në situatën që mund të krijohet nga reshjet e shiut/dëbores në territorin e bashkisë.
- b. Në varësi të precipitimit të situatës të mbledhin komisionet e emergjencave të bashkive
- c. Të hartojnë vlersimin e rrishtit dhe prioritetet e ndërhyrjes në zonat më me rrisht nga reshjet e shiut/dëbora, duke përcaktuar rrezikun, numërin e familjeve të popullsisë dhe mbështetjen që kërkohet me sasinë dhe llojin e ndihmës së komunitetit në nevojë, duke informuar zyrtarisht Institucionin e Prefektit dhe projektet përkatëse ndërhyrëse.
- d. Të përcaktohen, parashikohen, planifikohen dhe shfrytëzohen maksimalisht në zbatim të nenit, nr.7, të Ligjit, Për MC, “Parimi i subsidiaritetit”, të gjitha kapacitetet logjistike dhe njerëzore, strukturat aktuale të emergjencës në organiken aktuale të bashkisë dhe në cdo qendër administrative për menaxhimin e situatave të pritshme prej izolimit nga Uji/dëbora në të gjithë territorin e bashkive sipas pikave të kontaktit dhe sektorëve apo procesit të punës që bëjnë.
- e. Të merren masat për depozitim dhe sigurimin e skorieve, granilit dhe kripës në të gjitha segmentet që bllokohen nga ngricat në territorin e bashkive dhe në mënyre të veçantë të

- gjithë sistemin hidraulik të furnizimit të popullatës me ujë të pijshem, me qëllim për të parandaluar ngrirjen e tubacioneve që shtrihen në territorin e çdo bashkie.
- f. Të merren masa për organizimin e skemave të sistemit të vrojtimit, lajmerimit, shkëmbimin e informacionit dhe të ndërhyrjes në të gjitha fshatrat e zonave që rrezikohen nga përmbytja dhe nga izolimi i dëborës, **duke përcaktuar personin apo institucionin përgjegjës, Drejtuesin Operacional dhe radhen e punës së informimit në kohë reale nëpërmjet grupit Whatsuup që menaxhon Sekretaria e KMCQ.**
  - g. Të përcaktohen dhe evidentohen sasia e mjeteve të transportit, kryesisht fadroma që u vijnë në mbështetje, mjetet e kalueshmerisë së lartë, grupet vullnetare që do të merren me hapjen e segmenteve rrugore, si dhe organizimin e levizjes së transportit për evakuimin e familjeve, apo udhëtarëve që rrezikohen nga përmbytja apo izolimi nga dëborë. **Listat e tyre me nr. e kontaktit të dërgohen pranë Institucionit të Prefektit.**
  - h. Të zbatohet, neni 65 i Ligjit, nr 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” që bën fjalë për Buxhetin e bashkive, vecanerisht zbatimi i VKM, nr.414, dt.8.07.2021 **“Për miratimin e Procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile”,** i cili parashikon procedurat e zbatimit të fondit të planifikuar dhe të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile, që duhet të zbatohet paraprakisht edhe në kërkesat standarte për mbështetje që do i drejtohen Institucioni të Prefektit, për të cilat do miratohen nga AKMC në ato zona ku nuk është e mundur për tu siguruar nga strukturat e bashkive.
  - i. Të merren masat nga kryetaret e bashkive Shkodër dhe M.Madhe për bashkëpunimin me Asutoritetin Verior, strukturat e DVP, të Qarkullimit Rrugor, të Shëndetësive për mirëmenaxhimin e Segmentit të Qafë Thorës, që në rastet e situatave kritike, të parandalojnë levizjen e përdoruesve të mjeteve duke bashkëpunuar me strukturat reaguese të cilat mund të dërgohen për mbështetjen e strukturave lokale, vetëm në rastet e emergjencave shëndetësore, kur është e pamundur hapja e këtij segmenti (rastet e reshjeve të dendura të dëborës, orteqe, temperatura nën-10 grade, ngrica).
  - j. Nga bashkia Shkodër të merren masat për të mbajtur të kalueshëm, aksin alternativ Postribe, Pult, Shosh, Shale, Theth me firmat kontraktuese.
  - k. Të bëhen paraprakisht listat e familjeve dhe personave endacakë për të krijuar mundësinë e transportit, strehimit dhe trajtimit ushqimor deri në largimin e vështirësive për shkaqe të izolimit nga përmbytja/dëborë në vendet e përshtatëshme për këtë qëllim.
  - l. Të kontaktojnë me bizneset private që ushtrojnë aktivitete në territorin e bashkive, apo bashkitë fqinje, që sigurojnë rezervat një mujore në ushqimore për komunitetin dhe për bagëtite për NJQV të zonave malore dhe në rrisht përmbytje, duke bërë statistikat përkatëse për çdo Bashki.
  - m. Të verifikojnë gjëndjen teknike të sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, sistemit hidraulik të furnizimit me ujë të popullatës, të përcaktojnë masat shtesë me ndermarjet e mvertësive që të mbajnë të hapura dhe në gadishmeri, sistemet e kullimit, tubacioneve të furnizimit me ujë të pijshem, kolektorëve të shkarkimit për të parandaluar ngrirjen.

- n. Të mbajnë në gadishmeri për ndërhyrje të menjëhershme resursët njerëzor dhe logjistik në të gjithë territorin që rrezikohet nga përmytjet dhe izolimin nga dëbora, kryesisht të segmenteve rrugore në varësi të bashkive.
  - o. Të informojnë në mënyrë periodike nëpërmjet grupit ehat supp të ngritur enkas nga Institucioni Prefektit për situatën e krijuar në kuadrin e masave të mësipërme.
- 14. Masat në cdo rast Emergjent.**
- a. Të mbledhen KECB të organizojnë të gjithë burimet njerëzore dhe mjetet që ka në juridiksionin e bashkive dhe të aktivizojnë planet e emergjencave.
  - b. Të përcaktoni drejtuesit operacional për mirëmenaxhimin e situatës së përmytjes apo izolimit nga debora i cili duhet të miratohet me një akt ligjor nga cdo kryetar bashkive dhe të njoftohen zyrtarisht për njohje nga të gjitha strukturat e tjera në KMCQ.
  - c. Të krijohen grupet e punës për të bërë vlerësimin dhe ndërhyrje në zonat problematike.
  - d. Të organizoni punën me mjete dhe me vullnetarët që duhet të kenë në zonën që mund të rrezikohet nga përmytja/debora për evakuimin e familjeve e mundeshëm të banorëve, sipas planeve të evakuimit në vendet e paracaktuara dhe të planifikuara për akomodim të përkoshëm.
  - e. Të përcaktoni paraprakisht listën e familjeve në si dhe magazinimin e nevojave më të domosdoshme në ushqime dhe jetesë në zonën e izoluar nga Uji dhe dëbora për tu mbështetur në rast precipitimi të situatës, lista të cilat duhet të arshivohen paraprakisht edhe pranë Institucionit të Prefektit..
  - f. Të paraplanifikoni bashkëpunimin me strukturat e tjera mbështetëse që dërgohen për ndihmë (mbi bazen e kërkesave zyrtare) nga KMCQ, duke i përcaktuar konkretisht detyrën e këtyre strukturave në zonën e rrishtit, si (Ushtria, Policia, FNSH, Kompani private, OJF)
  - g. Të dergoni brenda datës 5 Nendor 2021, pikat e kontaktit të kompanive private sipas sektorit të përgjegjësisë dhe sasine e mjeteve për ndërhyrje sipas kontratave që kenë hartuar.
  - h. Të mbani komunikim të pandërprerë me Sektorin e EC, nëpërmjet Nr.0676947597 duke i dhënë informacion çdo dy orë.
  - i. Të hartoni planet e gadishmerisë me skenarë konkret për ndërhyrjet operationale në zonat e fatkeqësive.
  - j. Të përgatiten shabllonet e kërkesave dhe statistikave përkatëse mbi bazën e të cilave të informohet Institucioni i Prefektit për sasinë e segmenteve rrugorë të izoluar nga debora, shtëpive të izoluar/rrethuar nga uji, sipërfaqe toke, dhe dëmeve të tjera infrastrukturore për shkak të ngricave.
  - k. Të sensibilizoni nëpërmjet mediave komunitetin për pastrimin e rrugëve, kanalizimeve, shtëpitë të izoluar nga dëbora etj. Si dhe të angazhoni maksimalisht drejtorite dhe ndermarjet në nivel bashkie, MZSH dhe strukturat e tjera në varësi të tyre në momentet e para të rrezikut nga reshjet e shiut dhe dëbores.
  - l. Të organizoni të gjitha OJF-të e zonës për ti ardhur në ndihmë komunitetit të zonës në menaxhimin e situatës dhe bizneset private sipas planeve të gatishmërisë të përgatitura më parë.



**15. Masat për informim dhe sanksionet.**

- a. Nëpërmjet celularit me Nr.0676947597 i cili përfaqëson Sekretarinë e KMCQ, do shkëmbehen informacione të ndërsjellta nëpërmjet grupit Whatsuup i ngritur enkas për menaxhimin e situatave emergjente në të gjithë territorin e Qarkut. Tërheqim vemendjen e detyrimit të zbatimit të kësaj pike shume të rëndesishme për të gjitha strukturat anëtare të KMCQ dhe vecanerisht nga Sallat e DVP, komisariatet e bashkive, kryetaret e bashkive, të cilët të mireorganizojnë dhënien e informacioni nga baza në qender dhe anasjelltas, duke percaktuar personin pergjegjës. **Cdo dite**
- b. Radha e Komunikimit të informacionit nepermjet salles se DVP, për cdo rast emergjent, primar është kryetari i Bashkisë përkatëse ose N/Kryetari dhe drejtuesi Operacionale mbi bazen e urdherit të Kr të Bashkisë, kur situata është në territorin e përgjegjësive në juridiksionin e Drejtorisë apo inspektoriatit përgjegjës, dhe pastaj detyrimisht në Sekretarinë e KMCQ. **Cdo rast.**
- c. Të hartohen Planet e gadishmerise me skenar Përmbytjen/Deboren dhe të dergohen për njohje pranë Institucionit të prefektit, **deri me datë 5 Nendor 2023.**
- d. Në të gjitha drejtoritë qendrore, institucionet dhe Bashkitë që ushtrojnë aktivitet në territorin e Qarkut, duhet të ndryshojnë dhe freskohen, lista e anëtarëve të KMCQ, skemat e lajmerimit, numrat e kontakteve për të shkëmbyer informacion ditor për parandalimin dhe monitorimin e të gjitha situatave që ndodhin në territorin e Qarkut, **deri me dt.31 Tetor 2023.**
- e. Të informoni **cdo ditë në orën 08.00** në grupin Whatsapp dhe adresen emailit të Institucionit të Prefektit, për situatën që mund të krijohet në territorin e përgjegjësive, duke ngarkuar një person kontakti i cili do të komunikojë në mënyrë të pandërprerë me specialistet e Sektorit të ECK, pranë Institucionit të Prefektit, nëpërmjet celularit të Sekretarisë së KMCQ.
- f. Ky Plan Masash, ngarkon me detyrë të gjithë drejtuesit e institucioneve dhe kryetaret e bashkive, anëtarë të KMCQ, që ushtrojnë aktivitet në territorin e përgjegjësive të Qarkut Shkodër të cilët janë përgjegjës në detyrim të Ligjit, nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” të cilët duhet të informojnë më shkrim Institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër, për realizimin e detyrave të mësipërme, **deri me dt. 31 Tetor 2023.**

**KRYETARI I KOMISIONIT TE MBROJTJES CIVILE TE QARKUT**

**PREFEKTI  
MAJLINDA ANGONI**

